



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 156

**Tiranë – E martë, 21 korrik 2026**

## PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave  
nr. 547, datë 9.7.2026

Për një ndryshim në vendimin nr. 463, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”, të ndryshuar.....

Faqe

16201



**VENDIM**  
**Nr. 547, datë 9.7.2026****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 463, DATË 31.7.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E SKEMËS SË VEÇANTË TË GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË SUBJEKTEVE NË SEKTORIN E BUJQËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Marrëveshja tip, bashkëlidhur vendimit nr. 463, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me marrëveshjen tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Autorizohet ministri i Financave për nënshkrimin e marrëveshjeve të garancisë shtetërore me bankat tregtare të nivelit të dytë, të përfshira në skemë, në përputhje me ndryshimet e miratuara me këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

Këshilli i Ministrave  
Përfaqësuar nga  
Ministria e Financave

Banka Raiffeisen sh.a.  
Banka e Bashkuar e  
Shqipërisë sh.a.

Banka Kombëtare  
Tregtare sh.a.

Banka Tirana sh.a.

Banka Intesa Sanpaolo  
Albania sh.a.

Banka ProCredit sh.a.

Banka Amerikane e  
Investimeve sh.a.

Banka e Parë e  
Investimeve, Albania  
sh.a.

Banka Credins sh.a.

Banka OTP Albania  
sh.a.

Banka Union sh.a.

**MARRËVESHJE GARANCIE**  
**PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË**  
**SUBJEKTEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË**  
**MESME NË TË GJITHË SEKTORËT E**  
**EKONOMISË, SI DHE FERMERËVE TË**  
**REGJISTRUAR DHE TË PAJISUR ME**  
**CERTIFIKATËN E NIPT-it TË FERMERIT**  
**NË SEKTORIN E BUJQËSISË****MARRËVESHJE TIP**

Deri në 5 miliardë lekë

**Datë**

---

**PREAMBULË**

Qëllimi i skemës është të lehtësojë aksesin në financim për subjektet mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe për fermerët e regjistruar, duke mbështetur zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në sektorë me rëndësi strategjike për ekonominë. Gjithashtu, kjo skemë garancie mbështetet në programin e miratuar në Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Bankës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë dhe Bankave, përfaqësuar nga drejtorët ekzekutivë, “Për pjesëmarrjen në Programin e Financimit të Biznesit



Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri”, lidhur më 14.2.2025 në Tiranë. Kjo marrëveshje kuadër është nënshkruar në zbatim të vendimit nr. 3, datë 15.1.2025, të Këshillit Mbikëqyrës, “Për Miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe Dokumentacionit Shoqërues”, i ndryshuar me vendimin nr. 69, datë 17.12.2025, të ndryshuar me vendimin nr. 20, datë 6.5.2026, të ndryshuar me vendimin nr. 29, datë 1.7.2026.

Kjo marrëveshje garancie (“Marrëveshja e Garancisë”) e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (“MF”), dhe Bankave (“Huadhënësit”), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësve në këtë skemë garancie të lëshuar nga Ministria e Financave si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, menaxhuar nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (AMGKP), Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje përfaqësuar nga MF-ja), por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfutuesi i drejtpërdrejtë i huas (“Huamarrësi”) nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huan e garantuar (“Huaja”), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huas (“Marrëveshja e Huas”) dhe janë plotësuar kushtet e parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Për sa më sipër, si edhe për të mundësuar realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, palët bien dakord me kushtet si më poshtë.

#### Neni 1 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Garancie është hartuar mbështetur në:

- Nenet 34–43 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Nenin 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligjin nr. 55/2023, datë 29.12.2023, “Për Menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer”;

- Ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 30.6.2026;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 31.7.2025, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 30.6.2026, “Për disa ndryshime në vendimin nr.463, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”;

- Marrëveshjen kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Zëvendësguvernatori i Dytë dhe Bankave, përfaqësuar nga drejtorët ekzekutivë, “Për pjesëmarrjen në Programin e Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri”, lidhur më 14.2.2025 në Tiranë;

- Vendimin nr. 3, datë 15.1.2025, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, “Për miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe Dokumentacionit Shoqërues”;

- Vendimin nr. 69, datë 17.12.2025, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

- Vendimin nr. 20, datë 6.5.2026, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

- Vendimin nr. 29, datë 1.7.2026, i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

#### Neni 2 Garancia

1. MF-ja merr përsipër të garantojë Huadhënësit deri në vlerën 5 miliardë lekë (“Vlera e Garancisë”), sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje. Vlera e Garancisë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MF-ja për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga Huat që do t’i nënshtrohen kësaj skeme garancie. Shpërndarja e garancisë do të respektojë



vlerën totale prej 5 miliardë lekësh, nga të cilat vlera prej së paku 1.5 miliardë lekësh do jetë e dedikuar për sektorin e bujqësisë dhe pjesa e mbetur prej deri në 3.5 miliardë lekësh për sektorët e tjerë të ekonomisë.

Në rast se vlera e garancisë rritet në të ardhmen, Ministria e Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të rritjes së vlerës së garancisë dhe rritjes së vlerës së dedikuar për sektorin e bujqësisë, në rast se do vendoset të rritet, do të njoftojë Huadhënësit për vlerat e ndryshuara.

2. MF-ja merr përsipër të garantojë deri në vlerën e garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni, 70% të kryegjësë të çdo Huaje që Huadhënësit do t'u livrojnë Huamarrësve, sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje.

3. “Vlera e Garantuar e Huas” do të jetë shuma maksimale e garantuar nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje përkatësisht për secilën nga Huat e livruara nga Huadhënësit, në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe e cila do të jetë e barabartë me prodhimin e kryegjësë të Huas me përqindjen e kryegjësë të garantuar nga MF-ja, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Në asnjë rast, MF-ja nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penalteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar, që mund të burojë nga Huat që Huadhënësit do t'i livrojnë Huamarrësve.

5. Për qëllimin e mostejkalimit të vlerës së garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni, si dhe mundësimin e vlerës së dedikuar për sektorin e bujqësisë, Huadhënësit do të raportojnë menjëherë pranë AMGKP-së me *email* në adresat e përcaktuara në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje, për çdo aplikim të miratuar dhe shumën përkatëse. AMGKP-ja do t'i konfirmojë Huadhënësit përkatës nëse aplikimi i miratuar nga Huadhënësi nuk shkakton tejkalim të vlerës së garancisë, si dhe nuk shkakton tejkalim të vlerës prej 3.5 miliardë lekësh të garancive të dhëna në përfitim të sektorëve të tjerë, dhe vetëm pas marrjes së këtij konfirmimi, Huadhënësi mund të procedojë me lidhjen e kontratës përkatëse të kredisë, dhe njofton menjëherë AMGKP-së për nënshkrimin e Kontratës së Kredisë.

Neni 3

### Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas

1. Huadhënësit do të japin Hua të garantuar sipas kësaj Marrëveshjeje subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme, sipas tipit të sektorit, në bazë të klasifikimit NACE, si më poshtë dhe të detajuara sipas aneksit 2, si dhe për fermerët e regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë:

- A01–A03: Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (sektor prioritar me kuotë të garantuar);
- C10–C23: Industria ushqimore, tekstili, kimikate, metalurgjia dhe industria prodhuese;
- C31–C33: Prodhimi i mobilie dhe industritë e tjera përpunuese; riparimi dhe instalimi;
- G45–G47: Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave;
- H49–H53: Transporti rrugor, detar dhe ajror; magazinimi dhe aktivitetet postare;
- I55–I56: Akomodimi; aktivitetet e shërbimit ushqimor dhe të pijes;
- J58–J63: Botimi; prodhimi audiovizual; telekomunikacioni; teknologjia e informacionit;
- M69–M75: Shërbimet juridike, kontabiliteti, konsulenca, shkencat dhe teknologjia;
- N77–N82: Qiradhënia; aktivitetet e punësimit; turizmi; shërbime mbështetëse biznesi;
- Përfitues të skemës mund të jenë edhe *joint venture* të krijuara ndërmjet personave juridikë publikë dhe personave juridikë privatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Subjektet do të dorëzojnë pranë Huadhënësve:

- a) Formularin e aplikimit;
- b) Projektpropozimin;
- c) Subjektet juridike duhet të dorëzojnë, ekstrakt të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, ndërsa fermerët duhet të dorëzojnë, certifikatë regjistrimi, vërtetim për llojin e aktivitetit bujqësor;
- d) Në rastin e *joint venture* paraqitet edhe marrëveshja e krijimit të *joint venture*, akti i autorizimit të përfaqësuesit, si dhe dokumentacioni për secilin anëtar, sipas këtij vendimi.

3. Huamarrësit duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i cili klasifikohet si pjesë e ndërmarrjeve mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të



mesme”, pavarësisht sektorit të veprimtarisë, apo fermer i regjistruar dhe i pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë.

b) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Në rastin e *joint venture* të krijuar ndërmjet një personi juridik publik dhe një personi juridik privat, secili anëtar i *joint venture* duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

c) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara në momentin e aplikimit.

d) Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme, me statusin e kredisë 2, 3, 4, 5, 6 në momentin aktual në Regjistër Kredie.

e) Huamarrësi (aksionari, përfaqësuesi ligjor) nuk duhet të jenë gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme që dëmton interesat financiarë të fondeve publike;

f) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime në historik dhe në momentin aktual ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga Skema të mëparshme të Garancive Shtetërore miratuar, me:

1) VKM-ja nr. 277, datë 6.4.2020, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e këshillit të ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së mirëkuptimit;

2) VKM-ja nr. 387, datë 13.5.2020, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit;

3) VKM-ja nr. 349, datë 26.5.2022, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave me qëllim përballimin e situatës

së veçantë të krijuar në treg, si edhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”;

4) VKM-ja nr. 221, datë 9.4.2024, “Miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për **garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese**, kategoria NACE 2, **për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë**, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”;

Huamarrësi dorëzon formularin e vetëdeklarimit për këtë qëllim pranë Huadhënësit.

4. Qëllimi i përdorimit të fondeve të Huas është për t’i mundësuar Huamarrësit fondet e nevojshme për investime për asete fizike dhe teknologjike që rrisin kapacitetet prodhuese, cilësinë e prodhimit dhe eficiencën operationale të tyre.

Në asnjë rast fondet e Huas nuk do të financojnë veprimtari të jashtëligjshme, apo të rifinancojnë hua të tjera.

5. Huamarrësi duhet të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuar në aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja e Mirëkuptimit duhet të jetë, gjithashtu, pjesë e Kontratës së Kredisë si aneks i saj, në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

6. Huamarrësi duhet të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit që do t’i vendoset në dispozicion nga Huadhënësit, nëpërmjet të cilit deklaron se Fondet e Huas do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në pikën 1 dhe në pikën 4 të këtij neni. Gjithashtu, në formularin e vetëdeklarimit, Huamarrësi duhet të deklarojë kreditë e aprovuara dhe ato në proces aplikimi/aprovimi në emër të Huamarrësit, të aprovuara, apo në proces aprovimi brenda kësaj skeme garancie nga institucionet e tjera huadhënëse.

7. Afati i aplikimit pranë Huadhënësve përfundon më 20.11.2027. Kreditë duhet të disbusohen jo më vonë se 20.12.2027.

8. Huamarrësi duhet të përmbushë kriteret financiare dhe ligjore të përcaktuara në aktet rregullative të bankës përkatëse në të cilën aplikohet për kredi.

9. MF-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të rishikojë, shtojë ose heqë çdonjërin prej kriterëve të cituara në pikat e mësipërme të këtij neni, në dakordësi me Huadhënësit, ku ndryshimi do të



bëhet efektiv pas nënshkrimit të dokumentit ndryshues ndërmjet MF-ja dhe Huadhënësve. MF-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të zgjatë afatin e parashikuar në pikën 7 të këtij neni, duke vendosur në dijeni paraprakisht Huadhënësit. Ky ndryshim do të bëhet efektiv 10 ditë pune pas marrjes së njofimit me shkrim të MF-së nga Huadhënësit. Asnjë ndryshim i bërë në përputhje me këtë pikë nuk do të ndikojë mbi Huamarrësit, Huaja e të cilëve është aprovuar përpara datës së bërjes efektive të këtij ndryshimi.

10. Me përjashtim të rasteve siç përcaktohet në pikën 9 të këtij neni, Huadhënësit në asnjë rast nuk do të aprovojë kërkesat për Hua të Huamarrësve, të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1–7 të këtij neni.

#### Neni 4

##### Detyrimet e Huadhënësve

1. Huadhënësit angazhohen të përdorin formularë aplikimi që mundësojnë sigurimin e plotë të të gjithë informacionit të cituar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me praktikën e tij bankare për këto produkte.

2. Huadhënësit mbajnë përgjegjësi për plotësimin e dokumenteve të aplikimit për Hua dhe janë të detyruar të mbajnë kopje të këtyre dokumenteve në arkivat e veta.

3. Huadhënësit do t'i trajtojnë Huat që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje me profesionalizëm dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e brendshme që ato aplikojnë gjatë aktivitetit të tyre të zakonshëm të kredithënies për produkte bankare tregtare të ngjashme, si edhe në përputhje me përmbajtjen e nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Huadhënësit do të bëjnë vlerësimin e rrezikut kredit të Huamarrësve, në përputhje me standardet dhe legjislacionin bankar.

5. Huadhënësit duhet të regjistrojnë Huan menjëherë pas livrimit në regjistrin e kredive me një emërtim të veçantë në një fushë të posaçme që do të përcaktohet me këtë qëllim. Ky emërtim do të konvertohet në një kod specifik, i cili do të përdoret për të identifikuar këto kredi në linjë me rastet e ngjashme.

6. Gjithashtu, Huadhënësit në përputhje me nenin 3, pika 3 dhe pika 6, duhet t'i vendosin në dispozicion Huamarrësit formularin e

vetëdeklarimit, sipas formës dhe përmbajtjes që Huadhënësi e gjykon të arsyeshme.

7. Huadhënësit nuk duhet të favorizojnë asnjë Huamarrës mbi bazën e kriterëve të tij preferencialë.

8. Huadhënësit duhet të japin në dispozicion të AMGKP-së kopje të të gjitha dosjeve, ekstrakteve, dokumenteve, dhe të dhënave të regjistruara për të gjitha Huat që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje Garancie.

9. Huadhënësit duhet të shqyrtojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe të aprovjnë Huan, në përputhje me afatet dhe procedurat e brendshme, duke garantuar transferimin e fondeve në llogarinë e Huamarrësit dhe përdorimin e Huas, për qëllimet e mbuluara nga garancia shtetërore.

10. Huadhënësit duhet të sigurojnë që të gjitha veprimet dhe vendimet e tij, në lidhje me huadhënien dhe menaxhimin e Huave të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale bankare dhe financiare të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

##### Termat dhe kushtet e Huas

1. Vlera e Huas e vendosur në dispozicion nga Huadhënësit për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por në asnjë rast totali i kredive të dhëna për huamarrësin nga bankat, sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, nuk do të jetë më i lartë se rreth 200,000,000 (dyqind milionë) lekë.

2. Afati i Huas duhet të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por ky afat nuk mund të jetë më shumë se 10 (dhjetë) vjet.

3. Huaja të jetë në formën e një produkti të kredisë bankare që të përmbajë një skedul të qartë të shlyerjes së huas, pra kreditë nuk mund të kenë formën e linjave të kredisë.

4. Huadhënësit, bazuar në vlerësimet e riskut të kreditit për secilin Huamarrës gëzojnë të drejtën që të kërkojnë ose jokolateral shtesë nga Huamarrësi, por në asnjë rast masa e kërkuar e kolateralit duke përfshirë edhe Vlerën e Garantuar të Huas, sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të tejkalojë mbulimin e përllogaritur sipas legjislacionit dhe rregullave të brendshme të Huadhënësit.

5. Në rastet e parapagimit të Huas, Huadhënësit nuk duhet të aplikojnë komision, penalitet apo çfarëdo lloj mase tjetër që lidhet me parapagimin e Huas.



6. Monedha e Huas është monedha kombëtare lek.

7. Norma e interesit të kredive të kontraktuara dhe disbursuara do të jetë jo më e lartë se 2%. Tarifat e aplikueshme kundrejt huamarrësve për dhënien e kredisë nuk duhet të jenë në total më të larta se niveli maksimal prej 0.5%.

8. Periudha pa pagesë principali (grace) nuk do të jetë më pak se 12 muaj, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi preferon një periudhë më të shkurtër.

9. Huadhënësit do ta ofrojnë kredinë duke aplikuar penalitete për pagesat e vonuara jo më të larta se penalitetet e përcaktuara në kushtet standarde përkatëse. Huadhënësit nuk do të aplikojnë penalitete për shlyerje të parakohshme të kredisë.

10. Termat dhe kushtet e Huas do të përcaktohen në Marrëveshjen e Huas, e cila do të nënshkruhet ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve, në përputhje me përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje. Termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, të cilat bien në kundërshtim me këtë Marrëveshje do të konsiderohen të pavlefshme për të përfituar nga garancia shtetërore dhe nuk do të prodhojnë asnjë efekt kundrejt MF-së.

11. Asnjë transferim i të drejtave apo detyrimeve të Huadhënësve që burojnë nga kjo Marrëveshje ose nga Marrëveshja e Huas nuk mund t'u transferohet palëve të treta pa marrë paraprakisht aprovimin me shkrim të MF-së.

12. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas, që mund të bëhet në marrëveshjen ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, nuk është i nevojshëm miratimi i MF-së, me kusht që këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Huadhënësve kundrejt MF-së, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Huadhënësit do të njoftojnë me shkrim AMGKP-në për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas brenda një afati prej 10 ditëve pune nga nënshkrimi i dokumentit ndryshues.

13. Huadhënësit janë përgjegjës që totali i shumës së vlerës së garantuar të Huave, të mos tejkalojë Vlerën e Garancisë të lëshuar nga MF-ja, në favor të bankave, sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje. Në asnjë rast, tejkalimi i vlerës së garancisë nuk do të përbëjë detyrim për MF-në.

14. Huaja do të quhet e përfunduar dhe nuk do të jetë më objekt i kësaj Marrëveshjeje, vetëm pasi të

jetë paguar plotësisht nga Huamarrësi, në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas. Huadhënësit duhet të njoftojnë me shkrim AMGKP-në për të gjitha Huat e përfunduara, brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të tyre.

15. Huadhënësit duhet të njoftojnë me shkrim AMGKP-në për ndryshimin e administratorit të huamarrësit, në rastet e shitjes, dhurimit, transferimit të kuotave të shoqërisë, brenda një afati prej 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit nga Huamarrësi. Huadhënësit mundësojnë përfshirjen në kontratën e kredisë të detyrimit të huamarrësit për dërgimin e këtij njoftimi.

#### Neni 6

#### Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë

1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryejë pagesën e detyrimeve që mbulohen nga Garancia (*pagesën e kryegjësë*), dhe kur Huadhënësit brenda një periudhë jo më pak se 180 ditë kalendarike, nga dita e parë e lindjes së detyrimit nga Huamarrësi sipas skedulit fillestar të shlyerjes së *kryegjësë* të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas (pra nga kësti i parë që del me vonesë), kanë ndërmarrë të gjithë hapat e përcaktuar në procedurat dhe politikat e tij të brendshme për ndjekjen e huave të papaguara, atëherë Huadhënësit rezervojnë të drejtën për t'i dërguar AMGKP-së kërkesën me shkrim për pagesën ("Kërkesa për Pagesë") e garancisë. Shuma e garancisë duhet paguar në total 70% e kryegjësë së papaguar dhe jo vetëm e kështit/kështeve në vonesë.

2. Kërkesa për pagesë që Huadhënësit do t'i drejtojnë AMGKP-së duhet të përmbajë:

a) Vlerën e pagesës të përlogaritur, në përputhje me pikën 3 të nenit 2, kopje të Marrëveshjes së Huas, si edhe një përshkrim të detajuar të detyrimeve, duke përcaktuar në mënyrë analitike kryegjënë, interesat e akumuluar, penalitetet, dhe çdo detyrim tjetër në zbatim të Marrëveshjes së Huas dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht se MF-ja garanton vetëm kryegjënë në masën 70%.

b) Një përshkrim të të gjitha procedurave të ndjekura nga Huadhënësit përgjatë periudhës 180-ditore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rikuperuar detyrimet nga Huamarrësi, nga momenti



i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të kërkesës për pagesë.

Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të gjithë veprimeve të kryera nga Banka, konkretisht, si: tentativa për kontaktimin e huamarrësit, njoftimet drejtuar huamarrësit, procedura ligjore të ndërmarra nga Bankat si kërkesë drejtuar Gjykatës për lëshim urdhri ekzekutimi etj., nga Bankat për vjeljen e detyrimit, para thirrjes së garancisë, përgjatë periudhës 180-ditore.

c) Numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MF-ja.

3. AMGKP-ja, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas, përcjell pranë MF-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës për pagesë, njoftimin për pagesë. MF-ja autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit për pagesë nga AMGKP-ja.

Nëse AMGKP-ja e vlerëson të arsyeshme, përpara njoftimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësit.

4. MF-ja nuk ka asnjë detyrim ndaj kërkesave për pagesë, të cilat mund të burojnë nga vjedhja, materializimi i risqeve operationale të Huadhënësve, ose për çdo arsye tjetër që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje.

#### Neni 7

#### Rikuperimi postpagesës së garancisë

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë për ndonjë prej Huave, MF-ja merr në dorëzim menjëherë të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, në masën e çdo pagese të kryer nga MF-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua, që zotëronin Huadhënësit ndaj Huamarrësve, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë MF-ja, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

2. MF-ja, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, autorizon Huadhënësit që të ndjekin, në emër dhe për llogari të MF-ja, të gjitha procedurat e rikuperimit dhe ekzekutimit të detyrimeve, në

përputhje me procedurat ligjore dhe praktikat e sektorit bankar, për të gjithë shumën e detyrimit të Huamarrësve. Në çdo rast Huadhënësit marrin përsipër të kryejnë të paktën të njëjtat procedura për rikuperimin e detyrimit, ashtu si për detyrimin e vetë Huadhënësve. Huadhënësit janë të detyruar të njoftojnë menjëherë AMGKP-ja për çdo veprim procedural të kryer gjatë procedurës së ekzekutimit vullnetar ose të detyrueshëm, me qëllim që të mos cenohen të drejtat materiale apo procedurale të MF-së. Përfundimisht, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit.

3. Nëse pas 2 (dy) vjetëve nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësit nuk kanë mundur të rikuperojnë detyrimet e Huamarrësve, MF-ja zotëron të drejtën që të ndjekë vetë procedurat ligjore për rikuperimin e detyrimeve në masën e çdo pagese të kryer nga MF-ja, në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

4. Nëse pas pagesës së garancisë nga MF-ja për ndonjë prej Huave, Huadhënësit brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni rikuperojnë një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huas (duke përfshirë edhe rikuperimin nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit, nëse ka një të tillë) që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësit brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune duhet të njoftojnë me shkrim MF-në dhe AMGKP-ja, në lidhje me vlerën e rikuperuar, procedurat e rikuperimit, shpenzimet e rikuperimit, si dhe vlerën e interesave dhe kamatave ligjore, që duhet të paguhet dhe çdo detaj tjetër që gjykojnë të arsyeshëm në lidhje me rikuperimin.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, MF-ja udhëzon me shkrim Huadhënësit në lidhje me detajet e pagesës. Afati për kryerjen e pagesës nga Huadhënësit në favor të MF-së do të jetë, si më poshtë:

a) Në rastin kur rikuperimi është në formën e mjeteve monetare (*cash*), pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MF-ja, pasi Huadhënësit të kenë zbritur më parë detyrimin e kredisë, për pjesën e pambuluar me



garanci, si dhe çdo shpenzim të akumuluar për rikuperim.

b) Në rastin kur rikuperimi nuk është në formën e mjeteve monetare, pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e konvertimit të rikuperimit në mjete monetare (*cash*). Konvertimi i rikuperimit në mjete monetare (*cash*) do të kryhet në përputhje me procedurat dhe politikat e Huadhënësve për këtë qëllim.

5. Vlera që Huadhënësit paguajnë në favor të MF-së, në rast të rikuperimit të detyrimit të Huamarrësve nga Huadhënësve pas pagesës së garancisë, është e barabartë me vlerën e rikuperuar pasi t'i jenë zbritur shpenzimet për rikuperimin e Huas, dhe ku vlera e mbetur pasi janë zbritur interesat e papaguar, kamatat ligjore sipas K.Pr.Civile, si dhe shpenzimet ligjore e përmbartimore të kryera nga Huadhënësit, të ndahet ndërmjet Huadhënësit dhe MF-së, në raportet përkatësisht prej 30% për huadhënësit dhe 70% për MF-në, me përjashtim të rastit kur rikuperimi është mundësuar nga kolateral i vënë për kredinë sipas nenit 5, pika 4, të kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, Huadhënësit paguajnë në favor të MF-së vlerën e mbetur, pasi ka mbajtur plotësisht detyrimet e Huamarrësve kundrejt Huadhënësve.

6. Në rast se Huamarrësit, përveç detyrimit që buron nga Huaja nën këtë Marrëveshje Garancie kanë edhe detyrime të tjera ndaj Huadhënësve, atëherë ndjekja e detyrimit që buron nga kjo Hua ndiqet njëkohësisht me ndjekjen e detyrimeve të tjera, pa asnjë lloj diskriminimi nga Huadhënësit, pa cenuar rankimin e kredive dhe kushtet e huave dhe garancive respektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

### Raportimi dhe monitorimi

1. Huadhënësit do të raportojnë në formë elektronike pranë AMGKP-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e secilit muaj, për Huat e aprovuara prej tyre në muajin paraardhës, duke përcjellë shumën e disbursuar, skedulën e amortizimit të Huave, Marrëveshjen e Mirëkuptimit origjinale, si edhe kopje të dokumenteve shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas, sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huadhënësit gjithashtu do të raportojnë në formë elektronike dhe shkresore në bazë mujore pranë AMGKP-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huas, duke përfshirë në raportim informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huas nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huas.

3. Huadhënësit angazhohen të raportojnë në mënyrë periodike (çdo muaj) pranë AZHBR-së, të dhënat e detajuara mbi aplikantët (fermerë dhe subjekte), si dhe përfituesit në kuadër të skemës së garancisë shtetërore për pjesën e rezervuar për sektorin e bujqësisë, si dhe pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Raportimi do të përfshijë informacionin mbi numrin e kredive të dhëna, llojin e investimit, shumën e financimit, statusin e kredive dhe çdo element tjetër të nevojshëm për vlerësimin e ecurisë së skemës.

4. Raportimet në lidhje me këtë nen, si dhe komunikimet për nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen në formë elektronike ose me shkrim sipas rasteve të përcaktuara në nenet përkatëse. Ato duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

#### Për Ministrinë e Financave:

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Faks: .....

#### Për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit:

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

#### Për AZHBR-në:

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

#### Për AMGKP-në:

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**Për:****- Banka Raiffeisen sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka Kombëtare Tregtare sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka Tirana sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka ProCredit sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka Amerikane e Investimeve sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**-Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**-Banka Credins sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**-Banka OTP Albania sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

**- Banka Union sh.a.**

[Adresa] .....

Në vëmendje të: .....

Email: .....

Faks: .....

## Neni 9

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, zgjidhja e tyre do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës administrative shqiptare.

## Neni 10

**Vlefshmëria e dispozitave**

Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 11

**Hyrja në fuqi dhe efektiviteti**

Kjo Marrëveshje Garancie do të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit nga palët dhe do të bëhet efektive pas disbursimit të Huas ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve.



### Neni 12 Nënshkrimi

Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje në ( ) kopje origjinale të barasvlershme në gjuhën shqipe (një kopje për MF dhe nga një kopje për secilin nga Huadhënësit), në Tiranë, Shqipëri, në datat e përcaktuara në krye të kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 13 Përfundimi dhe pezullimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Garancie do të quhet e përfunduar kur të gjitha detyrimet ndërmjet palëve, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Huas dhe kjo Marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht, në rast se nuk do të kërkohej përfundimi përpara kohe i saj nga ana e MF-së ose Huadhënësve.

2. MF-ja mund të pezullojë Marrëveshjen e Garancisë në çdo kohë, duke e njoftuar me shkrim Huadhënësit, në rast se MF-ja vërteton se Huadhënësit kanë kryer një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, ose është përfshirë në një mashttrim i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë të MF-ja;

3. Përfundimi apo pezullimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ketë efekt mbi Huat që janë disbursuar në përputhje me kushtet e marrëveshjes deri në datën e hyrjes në fuqi të përfundimit apo pezullimit. Huat e disbursuara në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Garancisë do të vijojnë të jenë të garantuara nga kjo garanci shtetërore deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve të Huamarrësve.

KËSHILLI I MINISTRAVE  
PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E FINANCAVE  
**Petrit Malaj**

- **Banka Raiffeisen sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Kombëtare Tregtare sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Tirana sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka ProCredit sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Amerikane e Investimeve sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Credins sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka OTP Albania sh.a.**  
ADMINISTRATOR

- **Banka Union sh.a.**  
ADMINISTRATOR

### ANEKSI 1

### MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI (FORMAT TIP)

Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 676, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

[Emërtimi i Huamarrësit] bie dakord të nënshkruaj këtë Marrëveshje Mirëkuptimi në datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi i Garancisë Shtetërore të Huas, sipas Marrëveshjes së Garancisë nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026.

Në rast kompensimi të humbjeve nga MF-ja për pagesa që burojnë nga Marrëveshja e Huas sipas Marrëveshjes së Garancisë cituar në paragrafin e mësipërm, [Emërtimi i Huamarrësit] në zbatim të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, është i detyruar t'i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huas, përfshirë dhe të gjitha kostot që mund të lidhen me të.



Në rast të kundërt [Emërtimi i Huamarrësit] është në dijeni dhe pranon shprehimisht se MF-ja ka të drejtën për të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe në ligje të tjera në fuqi, dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfituar nga [Emërtimi i Huamarrësit] çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, si dhe kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas marrëveshjes së garancisë; si dhe që Marrëveshja e Mirëkuptimit përbën akt në kuptimin e nenit 510, pika (d) të Kodit të Procedurës Civile, duke u siguruar që të përmbushë elementet e kërkuara nga dispozita e sipërcituar.

[Emërtimi i Huamarrësit]

Nënshkrimi

## ANEKSI 2

### Sektorët dhe investimet e mbështetura

#### 1. Sektorët dhe investimet e mbështetura

Investimet e pranueshme kufizohen në investime teknologjike, eficiencë energjetike, certifikime, standarde ndërkombëtare, digjitalizim dhe logjistike:

a) Makineri dhe pajisje prodhuese: linja prodhimi, makineri CNC, pajisje ambalazhimi, pajisje frigoriferike dhe zinxhiri ftohës (*cold - chain*), pajisje kontrolli cilësie.

b) Digjitalizim i proceseve: ERP, softëra prodhimi dhe magazinimi, CRM, sisteme gjurmimi, tregti elektronike, zgjidhje cloud dhe sigurinë kibernetike.

c) Certifikime dhe standarde ndërkombëtare: HACCP, ISO, GlobalG.A.P., CE markimi, pajisje laboratorit dhe testimi, sisteme menaxhimi të cilësisë.

d) Eficiencë energjetike dhe konkurrueshmëri e gjelbër: panele diellore për konsum vetjak, motorë efikasë, sisteme ngrohje-ftohje me eficiencë të lartë, rikuperim energjie, pajisje me konsum të reduktuar.

e) Logjistikë, magazinim dhe infrastrukturë funksionale: magazina, dhoma frigoriferike (*cold-storage*), sisteme shpërndarjeje, automjete komerciale, platforma logjistike, pajisje ngritëse dhe automatizim depoje.

- Investim në tokë: i pranueshëm kur toka është pjesë integrale e projektit investues (sektor bujqësor dhe agropërpunim).

- Subjektet e pranueshme: NVM-ja sipas ligjit nr. 43/2022, fermerë me NIPT – fermer; përfshirja e fermerëve të paregjistruar në QKB.

#### 2. Klasifikimi NACE:

Huadhënësit do të japin Hua të garantuar subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme, sipas tipit të sektorit, në bazë të klasifikimit NACE si më poshtë:

- A01–A03: Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (sektor prioritar me kuotë të garantuar);

- C10–C23: Industria ushqimore, tekstili, kimikate, metalurgjia dhe industria prodhuese;

- C31–C33: Prodhimi i mobilieve dhe industritë e tjera përpunuese; riparimi dhe instalimi;

- G45–G47: Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave;

- H49–H53: Transporti rrugor, detar dhe ajror; magazinimi dhe aktivitetet postare;

- I55–I56: Akomodimi; aktivitetet e shërbimit ushqimor dhe të pijes;

- J58–J63: Botimi; prodhimi audiovizual; telekomunikacioni; teknologjia e informacionit;

- M69–M75: Shërbimet juridike, kontabiliteti, konsulenca, shkencat dhe teknologjia;

- N77–N82: Qiradhënia; aktivitetet e punësimit; turizmi; shërbime mbështetëse biznesi.

- Përfitues të skemës mund të jenë edhe *joint venture* të krijuara ndërmjet personave juridikë publikë dhe personave juridikë privatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.







Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 156]Datë: 21.07.2026 15:27:54  
+02:00]7922860d-e25b-4a6f-ab60-6ac6437a49cd

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)